



## Aplikim për vizë me qëllim nisjen e një marrëdhënieje punësimi në Republikën Federale të Gjermanisë si shofer profesionist

Lutemi të lexoni me kujdes këtë fletë-informacioni dhe formularin e aplikimit dhe respektoni saktësisht kërkesat.

Aplikimet e plotësuara në mënyrë të mangët apo dokumentacioni i paplotë mund të çojnë në refuzimin e aplikimit me pasojë rezervimin e një date të re aplikimi, përfshirë kohët përkatëse të pritjes.

Udhëzim i rëndësishëm: Çdo veprimtari punësimi parashikon drejtimin e një automjeti kategorizohet në profilin e shoferit profesionist. Këtu bëjnë pjesë korrierët, furnitorët, shoferët e kamionëve etj.

Në rastin e aplikimit për vizë Ambasada, si rregull, duhet të përfshijë në procedurë zyrën përkatëse për të huajt në Gjermani. Procedurat zgjasin zakonisht 2 - 4 javë, dhe në rast qëndrimesh të konsiderueshme në të shkuarën në Gjermani mund të zgjasin edhe më tepër. Ndaj lutemi për mirëkuptimin Tuaj që brenda 5 javëve të para, prej ditës së aplikimit, nuk mund t'u japim përgjigje pyetjeve lidhur me stadin aktual të procedurës.

Nëse në 24 muajt përpara aplikimit për vizë keni marrë asistencë sipas Ligjit mbi Azilkërkimin do t'ju sugjeronim të mos aplikoni për vizë.

### Për aplikimin për vizë ju nevojiten dokumentat e përshkruar si më poshtë

1.	<b>Formularë aplikimi për vizë</b>	Në gjermanisht ose anglisht, copë 2, të plotësuara në mënyrë plotësisht të lexueshme, të nënshkuara personalisht.
2.	<b>Tarifa</b>	Tarifat dhe detyrimet duhet të paguhet <b>kesh në monedhën shqiptare LEK</b> . Tarifa është 75 Euro përlllogaritur me kursin aktual të këmbimit
3.	<b>Fotografi</b>	3 fotografi identike biometrike për pashaportë, jo më të vjetra se 6 muaj, me sfond të bardhë, madhësia 45x35 mm. Lutemi që në secilin prej dy formularëve të aplikimit të ngjisni nga një fotografi, ndërsa fotografinë e tretë silleni me vete si element të veçantë.
4.	<b>Pashaporta e udhëtimit</b>	Me të paktën dy faqe bosh. Lutemi mbani në konsideratë që afati i vlefshmërisë së pashaportës duhet të jetë të paktën tre muaj më i gjatë se kohëzgjatja e vizës. Sillni ju lutem <b>dy fotokopje</b> të fletës së plastifikuar me të dhënat personale. Si rregull pashaporta juaj e udhëtimit mbahet në sektorin e vizave për një periudhë 2-3 javore të trajtimit të kërkesës suaj. Nëse pashaporta ju duhet gjatë kësaj periudhe lutemi bëjeni këtë të ditur gjatë aplikimit.

5.	<b>Miratimi i vendit të punës ose kontrata e punës</b>	<b>Në origjinal, plus dy fotokopje.</b> Ditën e aplikimit për vizë <b>nuk duhet të jetë më e vjetër se 6 muaj</b> dhe të duhet të përmbajë këto të dhëna: <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Lloji i veprimtarisë</b></li> <li>• <b>Lejen e drejtimit të automjetit që kërkohet për atë lloj punësimi</b></li> <li>• <b>Periudha e punësimit</b></li> <li>• <b>Paga bruto në muaj ose paga bruto për orë</b></li> <li>• <b>Numri i orëve të punës në javë</b></li> </ul>
6	<b>Leja e drejtimit të automjetit</b>	<b>Në origjinal, plus dy fotokopje</b>
<b>Në rast se paraqitet një leje shqiptare e drejtimit të automjetit dhe në një angazhim të ardhshëm në Gjermani është e nevojshme një leje e drejtimit të automjeteve e klasit C1, C1E, C, CE, D1, D1E, D ose DE</b>		
8	<b>Regjistrimi në kursin përkatës të kualifikimit sipas sipas përcaktimeve të Ligjit për Kualifikimin e Shoferëve Profesionistë të Kamionëve (BKRFQG)</b>	Regjistrimi ju mundësohet zakonisht nga punëdhënësi juaj i ardhshëm
9	<b>Deklaratë nga punëdhënësi juaj</b>	Punëdhënësi juaj i ardhshëm deklaron me shkrim se në një formular të ambasadës, se ju mund të nisni veprimtarinë tuaj si shofer profesionist vetëm pas marrjes së kualifikimit përkatës, dhe se ai është në dijeni të faktit që provimi për marrjen e lejes së drejtimit të automjetit në Gjermani duhet të jepet jo më vonë se 6 muaj pas hyrjes në territorin federal gjerman.
<b>Në rast se paraqitet një leje shqiptare e drejtimit të automjetit dhe në një angazhim të ardhshëm, për të cilin në Gjermani është e nevojshme një leje e drejtimit të automjeteve e klasit A, AM ose B</b>		
7	<b>Deklaratë nga punëdhënësi juaj</b>	Punëdhënësi juaj i ardhshëm deklaron me shkrim se në një formular të ambasadës se ai është në dijeni të faktit që provimi për marrjen e lejes së drejtimit të automjetit në Gjermani duhet të jepet jo më vonë se 6 muaj pas hyrjes në territorin federal gjerman.

Në raste të veçanta gjatë aplikimit apo procedurave të lëshimit të vizës Ambasada mund të kërkojë dokumenta shtesë të përmendura në këtë fletë informacioni.

Lutemi të mbahet në konsideratë që ligji nuk ju njeh asnjë pretendim për lëshimin e një vize me qëllim punësimi në Gjermani.

Pavarësisht kohëzgjatjes së punësimit tuaj në Gjermani viza lëshohet me periudhë vlefshmërie prej 3-6 muajsh. Pas kësaj udhëtoni ju lutem sa më shpejt drejt Gjermanisë dhe drejtohuni menjëherë pranë Zyrës së të Huajve, e cila ndërmerr zgjatjen e lejes suaj të qëndrimit dhe është zyra e kontaktit për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me Ligjin për të Huajt.

#### **Klauzolë e përjashtimit nga përgjegjësia:**

Të gjitha informacionet e mësipërme përcillen pa garancinë se janë të sakta apo të plota. Ato bazohen në stadin informativ të ambasadës në momentin e hartimit të tyre.